



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 1
Prishtinë, më 16.10.2017, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi –Dragusha.

Munguan: Aida Dërguti, Visar Ymeri, Sergjan Mitroviç dhe Zafir Berisha.

Nga pjesëmarrësit e tjerë: Sanije Berisha, OSBE; Dren Ajeti e Rreze Hoxha, GSPJ dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Konstituimi i komisionit;
3. Shqyrtimi i draft-planit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor 2017;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Konstituimi i komisionit

Vjosa Osmani-Sadriu, fillimisht theksoi se ky komision, për dallim nga komisionet e tjera, kërkon një bashkëpunim të madh në mes të anëtarëve të tij dhe produktivitet në punë, pavarësisht se a vijnë nga pozita apo opozita. Në vazhdim, njoftoi se gjatë kësaj legjislature, komisioni përbëhet nga 11 anëtarë dhe ka një zgjerim të fushëveprimit të tij, edhe me çështjen e diasporës dhe investimeve strategjike.

Elmi Reçica, tha se pajtohet se politika e jashtme është përtej interesave të ngushta politike dhe se kjo periudhë do të jetë intensive, sa i përket angazhimeve të komisionit dhe politikës së jashtme.

Time Kadrijaj, vlerësoi se komisioni kërkon angazhim, sepse pos politikës së jashtme, tani ka të përfshirë edhe dy dikastere, atë të diasporës dhe të investimeve strategjike. Ajo shtoi se politika duhet të mbetet jashtë komisioneve, në mënyrë që të arrihen objektivat dhe synimet tona.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Konstituohet Komisioni Funkcional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, i formuar në mbledhjen plenare, të mbajtur më 3 tetor 2017.

3. Shqyrtimi i draft-planit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor 2017

Vjosa Osmani-Sadriu, lidhur me planin e punës së Komisionit, theksoi se anëtarëve të komisionit u është shpërndarë një draft, i cili përmban disa nga prioritetet që mund t'i ketë komisioni gjatë këtyre tre muajve, që mund të plotësohet edhe me ide dhe iniciativa të tjera.

Në pikën VII të draftit të punës së komisionit, tha se janë një sërë çështjesh prioritare, që mund t'i ketë komisioni gjatë këtij tremujori, të cilat edhe i citoi. Në kuadër të pikës “Bashkëpunimi ndërparlamentar dhe hartimi i Strategjisë për bashkëpunim ndërparlamentar”, propozoi që fjala “Strategji” të zëvendësohet me fjalën “Plan i veprimit”, me arsyetimin se Kuvendi nuk ka kapacitetet që të hartojë strategji. Kryetarja propozoi mundësinë e inicimit parlamentar të plotësimin dhe ndryshimit të ligjeve, aty ku është e nevojshme, dhe ceku tema të tjera të cilat do të mund të ishin objekt i punës së komisionit, për këtë tremujor.

Lidhur me draftin e planit të ndarë në formë tabelore në muaj, tha se anëtarët e komisionit mund të dorëzojnë propozimet e tyre me shkrim, që në mbledhjen e radhës të miratohet plani i punës, por edhe tani mund të jepen propozimet dhe të miratohet plani i punës.

Time Kadrijaj, propozoi që të miratohet draft-programi i punës së komisionit, me pikat e parapara, ngase i njëjti mund të plotësohet ndërkohë, me çështje të tjera shtesë që mund t'i ketë komisioni.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se pajtohet që plani i punës të miratohet, duke pasur parasysh se i njëjti mund të plotësohet, varësisht nga aktivitetet që do të pasojnë. Ajo propozoi që edhe gjatë muajit dhjetor të ftohet në raportim MPJ, duke i ndarë çështjet se cilat do të raportohen në takimin e parë dhe cilat në takimin e dytë.

Dukagjin Gorani, bazuar në draft-planin e punës së komisionit, tha se në plan të punës janë tri nivele, ku komisioni do të përqendrohet më së shumti. Sa i përket marrëdhënieve ndërkombëtare, njohjet duhet të jenë prioritet kryesor, pastaj infrastruktura diplomatike të cilën e Republika e Kosovës e ka nëpër botë, si dhe definimi i saktë i termit investime strategjike, për të cilin tha se raportimet e ministrit të Jashtëm dhe atij të Diasporës e Investimeve Strategjike, duhet të shkojnë paralel. Po ashtu, tha se diplomacia parlamentare duhet të definohet qartë, në mënyrë që t'i jepet prioritet çështjeve që kanë rëndësi, karshi situatës në vend. Raportimin e ministrave, tha se e sheh si obligim të tyre dhe konsideron se ministri i Jashtëm do të duhej të raportojë çdo muaj, në komision.

Vjosa Osmani-Sadriu, duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Gorani, tha se duhet shqyrtuar Ligjin për investime strategjike, ngase jo të gjitha investimet e jashtme janë pjesë e këtij ligji. Pajtohet me propozimin që të ftohen për raportim në komision të dy ministrat së bashku, që do të mund të organizohet në muajin dhjetor. Kryetarja propozoi që në komision, po ashtu, të shqyrtohet programi i

Qeverisë nga fusha e politikës së jashtme, formimi i grupeve të miqësisë, avancimi i diplomacisë parlamentare, çështje e cila kërkon angazhim të jashtëm për hartim të një strategjie.

Ajo, në vazhdim, tha se gjatë muajit nëntor do të duhet të ftojme për diskutim institucionin i cili e ka tërhequr aplikacionin për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL e UNESCO dhe për strategjinë që tani e ka Kosova në këtë drejtim.

Kryetarja propozoi që gjatë muajit nëntor të organizohet një takim lidhur me avancimin e diplomacisë parlamentare, ku do të duhej të ftoheshin Ministria e Punëve të Jashtme, Ministra e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, kryetarët e grupeve të miqësisë, organizatat joqeveritare që merren me këtë çështje, përfaqësitë diplomatike, në mënyrë që të hartohet një plan konkret lidhur me diplomacinë. Në muajin dhjetor, tha se është paraparë shqyrtimi i Projektligjit të buxhetit të ministrive, të cilat bien në domenin e komisionit tonë dhe propozoi që të ftohet për raportim në muajin dhjetor, Komisioni Shtetëror për Demarkacionin. Lidhur me grupet e miqësisë, propozoi që të shqyrtohet lista e kaluar e grupeve të miqësisë, në mënyrë që komisioni të propozojë formimin e grupeve të miqësisë, gjatë kësaj legjislatore.

Dukagjin Gorani, tha se në media, ministrja e Integritimeve Evropiane ka deklaruar se çështja e demarkacionit mund të rinegociohet me Qeverinë e Malit të Zi dhe shprehu mendimin se duhet të kemi informacion më të detajuar lidhur me këtë çështje kaq të ndjeshme.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se sa i përket demarkacionit, janë dëgjuar informata kontradiktore, ku Presidenti thotë se kjo çështje është e mbyllur, Kryeministri e pret raportin e Komisionit të Demarkacionit, kurse ministrja e Integritimit thotë se do të rinegociohet. Kryetarja shtoi se komisioni duhet të ftojë ministrat e këtyre dikastereve dhe të merret një përgjigje përfundimtare. Ajo tha se komisioni duhet ta ketë të qartë se cili është plani i Qeverisë së Kosovës, nëse ka hapësirë për rinegocim, atëherë me çfarë strategjie apo me çfarë propozimesh do të shkojë pala kosovare në tavolinë me Malin e Zi, dhe nëse Mali i Zi nuk pranon rinegocim, atëherë cili është plani B.

Time Kadrijaj, tha se z. Haradinaj ka shkarkuar Komisionin për Demarkacion dhe se i ka caktuar njerëzit profesionistë në atë komision. Ajo shprehu mendimin se është me rëndësi që kjo çështje të zgjidhet, ashtu siç duhet dhe të kthehet kufiri, aty ku ka qenë. Duhet t'i japim hapësirë komisionit që është formuar, që të sjellë detajet e demarkacionit të kufirit dhe më pas të flasim, shtoi znj. Kadrijaj.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se Komisioni për Demarkacion nuk e definon se cila do të jetë qasja e Kosovës në raport me Malin e Zi, prandaj për të marrë një përgjigje të tillë, mund të ftohet ministrja për Integritim Evropian, së bashku me ministrin për Punë të Jashtme, sepse nuk duhet lejuar deklaratime kontradiktore. Ajo njoftoi se ftesat për ministra do të jetë konkrete, do të ftohen që të raportojnë para komisionit lidhur me qasjen e Republikës së Kosovës në raport me Marrëveshjen për Demarkacionin me Malin e Zi.

Elmi Reçica sa i përket dialogut Kosovë – Serbi, njoftoi se komisioni ka qenë i involvuar në këtë çështje, duke shtuar se ekziston një memorandum bashkëpunimi në mes të Kryetarit të Kuvendit dhe KDI-së.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Miratohet Planin dhe Programin e punës së Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike për sesionin vjeshtor të vitit 2017, me propozimet e anëtarëve të komisionit.

4. Të ndryshme

Vjosa Osmani-Sadriu, propozoi që Komisioni, në parim, mbledhjet t'i mbajë ditën e martë, në ora 11:00.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Mbledhjet e komisionit, në parim, do të mbahen ditën e martë, në ora 13:00.

Vjosa Osmani-Sadriu, njoftoi se në mbledhjen e radhës do të diskutohet lidhur me ftesat konkrete që do t'iu dërgohen ministrave, për çështjen e investimeve strategjike, si dhe lidhur me përgatitjen e ftesës drejtuar MFSK-së, për të diskutuar raportet e FSK-së, me NATO-n.

Sa i përket grupeve të miqësisë, tha se do të analizohet lista ekzistuese dhe cilat grupe të shteteve duhet të shtohen dhe t'i dërgohet Kryesisë për miratim.

Çështje tjetër që duhet të diskutohet, tha se është qasja e Presidentit të Kosovës ndaj raporteve të komisionit lidhur me dëgjimin e kandidatëve të propozuar për ambasadorë.

Elmi Reçica, njoftoi se komisioni, në legjislaturën e kaluar, ka dëgjuar një numër të caktuar në kandidatëve të propozuar për ambasadorë dhe se kjo çështje duhet të mbetet brenda komisionit të përbërjes së kaluar.

Dukagjin Gorani, propozoi që në mbledhjen e radhës të diskutohet edhe për diasporën dhe për mënyrën sesi do të funksionalizohet diaspora si entitet.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Vjosa Osmani-Sadriu